

8132

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT TIRANE
Nr. 8132

V E N D I M

**Per regjistrimin e Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar
"D O A R - S H P K"**

Sot me daten 17-1-95 une gjyqtarja Marijana Dea pasi shqyrtova kerkesen dhe dokumentacionin e paraqitur nga Dhimitrios Dollkas, Julia Dollka dhe Gani Cela per regjistrimin e shoqerise se tyre ne formen e nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar DOAR-SH.P.K. si person juridik

K O N S T A T O V A

Kerkuesit kerkojne ti regjistrojne si person juridik shoqerine me Pergjegjesi te kufizuar "DOAR-SH.P.k." me seli ne Berat, me kohezgjatje per 10 vjet, me kapital themeltar 100000 leke me ortake te tre kerkuesit, me administrator Dhimitrios Dollkas dhe Gani Cela me objektin import-eksport mallrash te ndryshme dhe veprimtari prodhimi drure gjith llojesh .
Kerkesa e tyre eshte e drejte dhe si e tille duhet te pranohet

P E R K E T O A R E S Y E :

Ne baze te Kodit Civil te Ligjit Nr.7638 date 10.11.1992 "Per shoqerite Tregtare,te Ligjit Nr.7667 date 28.01.1993" Per regjistrin Tregtar "

V E N D O S A :

Regjistrimin si person juridik te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "DOAR-SH.P.K" me seli ne Berat me kohezgjatje 10 vjet, me kapital themeltar 100.000 leke me ortake kerkuesit dhe administratoret Dhimitrios Dollkas dhe Gani Cela, me objekt Import-Eksport mallrash te ndryshme, dhe prodhime druri : si bufe, dhome gjumi, dyer-dritare, sallone, mobileri e paisje hotelesh, zyrash e dyqanesh, karrike e kolltuqe te llojeve te ndryshme, tapiceri e cdo lloj prodhimi druri.

Kunder ketij vendimi lejohet ankim ne shkallen e dyte.

G J Y Q T A R E

Marijana Dea
Dollka

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E SHKALLES PARE TIRANE

Nr. 8132/1 vendimit
Date _____

Tirane, me, ___/___/2005

V E N D I M
I G J Y Q T A R I T T E V E T E M

Sot me date 20.04.05 une gjyqtari i Gjykates se Shkalles Pare Tirane, [Signature], pasi shqyrtova kerkesen e paraqitur nga Adminstratori i shoqerise tregtare "DOAR".sh.p.k, Gani CELA, per depozitim prane rregjistrir tregtar te vendimit te Asamblese se Ortakeve te saj te dates 28.03.2005,

K O N S T A T O V A:

Se me vendim te Gjykates se Rrethit Tirane Nr. 8132 date 17.01.1995 eshte rregjistruar si person juridik shoqeria tregtare "DOAR" sh.p.k .

Me vendimin e dates 28.03.2005 te Asamblese se ortakeve te shoqerise tregtare "DOAR"sh.p.k, eshte vendosur:

1. Miratimi i shitjes se 40% te pjeseve te kapitalit themeltar qe zoteron ne shoqeri z.Dhimitrios DOLLKAS dhe 40% te pjeseve te kapitalit themeltar te ortakut zj. Julia DOLLKA te ortaku z.Gani CELA.
2. Pas shitjes tereresisht te pjeseve te kapitalit themeltar nga z. Dhimitrios DOLLKAS dhe zj.Julia DOLLKA, kapitali thmeltar zoterohet 100% nga z. Gani CELA.
3. Miratimin e doreheqjes si administrator te z.Dhimitrios DOLLKAS dhe zj. Julia DOLLKA pasi ata kane shitur teresisht pjeset e kapitalit themeltar te z.Gani CELA i cili ngelet administrator i vetem i shoqerise.
4. Ndryshimin e kohezgjatjes se veprimtarise se shoqerise. Kohezgjatja e veprimtarise se shoqerise eshte pa afat.

P E R K E T O A R S Y E:

Ne baze te ligjit nr.7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" dhe atij nr. 7667 date 28.01.1993 "Per rregjistrin tregetar"

V E N D O S A:

Pranimin e kerkeses.

Depozitim ne rregjistrin tregtar te vendimit te Ortakeve te shoqerise tregtare "DOAR" sh.p.k te dates 28.03.2005.

Ndaj vendimit lejohet ankim.

G J Y Q T A R E

[Signature]



KONTRATE

PER KRIJIMIN E SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

Ne Tirane, me 10.01.1995 te neneshkruarit:

1. Dhimitrios Dollkas, i Gjeorgjiu dhe Julias, lindur ne Athine me 17.06.1971 ,banues ne Athine rruga Rigas Fereos 36 shtetas grek, me pasaporten nr.Z-389282.

2. Julia Dollka, e Spiridhonit dhe Dhimitras, lindur ne Athine me 17.01.1951 banues ne Athine rruga Rigas Fereos, 36 shtetase greke, me pasaporte nr.K-319094.

3. Gani Cela, i Dajlanit dhe Ferasetes lindur ne Berat me 3.01.1957, banues ne Berat, rruga 28 nentori 17, shtetas shqiptar me leternjoftimin nr.QH- 019342.

Arriten marreveshjen per krijimin e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar ne perputhje me legjislacionin e Republikes se Shqiperise , ne kushtet qe vijojne:

N e n i 1

Emertimi i Shoqerise

"D O A R" SHPK

Qendra e Shoqerise

Ne Shqiperi: Berat -Lagje 28 Nentori, rruga Petrit Lerbo 17

Ne Greqi: Athine rruga Agjiu Joanu 7g

N e n i 2

Qellimi i Shoqerise (Objekti)

Import eksport i mallrave te ndryshme

Prodhime druri si: bufe, dhoma gjumi, dyer-dritare, sallona, mobileri e paisje hotelesh, zyrash e dyqanesh, karrike e kolltuqe te llojeve e te madhesive te ndryshme, tapiceri e cdo lloj punime druri.



Neni 3

Regjimi ekonomik

Shoqeria udhëhiqet në veprimtarinë e saj nga legjislacioni i Republikës së Shqipërisë dhe gezon mbrojtje dhe sigurim të plotë si investitor i huaj. Shoqeria gezon afirmim ligjor që nga dita e regjistrimit në regjistrin tregtar pranë gjykatës së rrethit Tirane.

Neni 4

Kapitali baze (themeltar)

Kapitali baze i shoqërisë është njëqindmije leke ose shuma në barazvlerë në dollare amerikane. Përqindjet e pjesëmarrjes së ortakëve në kapitalin baze janë:

Në përqindje:

-Dhimitrios Dollkas	40%
- Julia Dollka	40%
- Gani Cela	20%

Në leke:

-Dhimitrios Dollkas	40000 leke
- Julia Dollka	40000 leke
- Gani Cela	20000 leke

Kapitali baze mund të shtohet nga kontributet plotësuese të ortakëve sipas përqindjes së pjesëmarrjes me përjashtim kur unanimisht është vendosur e kundërta. Shtesa e kapitalit baze vendoset me shumicën e anëtarëve të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve.

Neni 5

Drejtimi i Shoqërisë

Drejtimi i Shoqërisë realizohet nga këto organe:

Asambleja e Ortakëve

Administratoret

Menyra e emerimit dhe kompetencat e tyre përcaktohen në statutin e shoqërisë.



N e n i 6

Sigurimi i Shoqerise

Pasuria e Shoqerise sigurohet ne baze te legjislacionit te Republikes se Shqiperise.

N e n i 7

Ndarja e fitimeve

Fitimi neto ndahet midis ortakeve sipas perqindjes se pjesemarrjes se tyre ne kapitalin baze, parashikuar ne nenin 4 te kesaj kontrate.
Ortaket e huaj mund te eksportojne lirisht jashte Shqiperise valuten e huaj ne perputhje me udhezimet dhe ligjin per investimet e huaja.

N e n i 8

Afati i veprimit te Shoqerise

Afati i veprimit te shoqerise eshte 10 vjet qe nga data e neneshkrimit te kesaj kontrate.
Afati i funksionimit te shoqerise eshte afati i veprimit te kontrates se krijimit qe fillon nga regjistrimi ne gjykate.

N e n i 9

Likujdimi i Shoqerise

Rastet dhe procedura e likujdimit te Shoqerise si dhe e mbarimit te afatit te kontrates se krijimit percaktohet ne statutin e Shoqerise.
Kontrata e krijimit mund te zgjidhet me vendim te Asamblese se Ortakeve.

N e n i 10

Dispozita te Pergjithshme

Kjo kontrate e krijimit ka si aneks Statutin e Shoqerise qe eshte pjese perberese e saj.
Adresa e Shoqerise eshte:

Ne Shqiperi: Berat - Lagje 28 Nentori, rruga Petrit Lerbo 17

Ne Greqi: Athine, rruga Agjiu Joanu 7g Tel: 00301-9922768.

Cdo ndryshim dhe shtese te kesaj kontrate te krijimit dhe te statutit behet me vendim te Asamblese se Ortakeve.
Kjo kontrate nenshkruhet ne Tirane me 10 janar 1995 dhe hartohet ne kater kopje.



ORTAKET

GANI CELA

G. Cella

JULIA DOLLKA

J. Dollka

DHIMITRIOS DOLLKAS

D. Dollkas

REPUBLIKA E SHQIPERISE

NOTERIA

Nr 130 Regj.

Nr 40 Kol.

VERTETIM

Në Tiranë sot date 17 Janar 1995 (nëntëdhjetë e pesë) përpara meje noteres Vjollca Skëndo u paraqitën personalisht shtetasit Gani Cëla, Julia Dollka, Dhimitros Dollkas, madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar me identitetin e të cilëve u garantova nëpërmjet letërnjoimeve të evidentuara më lart, të cilët nënshkruan pa verejtje kontratën dhe kërkesën e mësipërme te redaktuar jashtë kësaj zyre, ndaj unë notej vertetoj rregullisht nënshkrimin e tyre.

NOTERE

Vjollca Skëndo/



[Signature]



I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

"DOAR-SHPK"

Ne Tirane me 10.I.1995 te nenshkruarit :

- 1. Dhimitrios DOLLKAS**, i Gjeorgjias dhe i Julias, lindur ne Athine me 17.06.1971, banues ne Athine, Rruga Rigas Fereos, 36, Shtetas Grek, me pashaporten Nr.Z-389282
 - 2. Julia DOLLKA** e Spiridhonit dhe Dhimitras, lindur ne Athine me 17.01.1951, banues ne Athine Rruga Rigas Fereos, 36, Shtetas Grek me pashaporte Nr. K-319094.
 - 3. Gani CELA**, i Dajlanit dhe Ferasetes lindur ne Berat me 3.01.1957 banues ne Berat, Rruga 28 Nentori 17, shtetas Shqiptar me Leternjoftimin Nr. QH-O19342.
- Vendosen bashkarisht te miratojne kete statut te Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar :

K R E U I

QELLIMI, EMERIMI, QENDRA

N e n i 1: Qellimi i Shoqerise

Import-eksport mallrash te ndryshme
Prodhime druri si :

bufe, dhoma gjumi, dyer-dritare, sallone, mobileri e paisje hotelesh, zyrash e dyqanesh,
karrike e kolltuqe te llojeve e te madhesive te ndryshme, tapiceri e cdo lloj punime druri.


N e n i 2: Emertimi dhe qendra e shoqerise

Emertimi : "DOAR SHPK"

Qendra: Ne Shqiperi : Berat Lagja 28 Nentori, Rruga Petrit Lerbo, 17.
Ne Greqi : Athine, Rruga Agjiu Joano 7g

N e n i 3: Regjimi juridik

Shoqeria eshte Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar qe udhehiqet nga legjislacioni ne fuqi i Republikes se Shqiperise "Ligji mbi investimet e huaja dhe ligji Mbi shoqerite Tregtare". Me vendim unanim ortaket mund te ndryshojne regjimin juridik te shoqerise ne qoftese ne te ardhmen krijohen premisa me te favorshme per funksionimin e saj sipas legjislacionit shqiptar. Ne kete rast ortaket do t'ja pershtasin kontraten e krijimit dhe statutin e shoqerise si edhe regjistrimin e tyre nga organet kompetente shqiptare.



Shoqeria gezon personalitet juridik nga data e miratimit te regjistrimit te saj ne librin e regjistrimit te Shoqerise Tregtare nga organet kompetente te Shqiperise.
Shoqeria mund te kete pasuri ne perputhje me dispozitat e legjislacionit shqiptar. Pasuria m'brohet ne baze te dispozitave te ligjit "mbi investimet e huaja"
Shoqeria do te kete vulen te cilen do ta caktoje me vendimin e vet Asambleja e Ortakeve.

KREU II

TE DREJTA DHE DETYRA

Neni 4

Shoqeria ka te drejte te lidhi marreveshje dhe te nenshkruaj kontrata ne territorin e Shqiperise dhe jashte saj.

Shoqeria gezon te drejten qe te beje importime dhe eksportime te nevojshme per realizimin e qellimeve te saj pa asnje pengese. Gjithashtu ka te drejten e importimit pa asnje obligim e tatim te mjeteve te nevojshme materiale per materializimin e qellimeve investuese.

Shoqeria gezon te drejten e caktimit te cmimeve te produkteteve te saj qe do te disponoje per tregun e brendshem e te jashtem sipas rregullave te legjislacionit ne fuqi.

Shoqeria ka te drejten e administrimit ekskluziv te pasurise ne baze te legjislacionit ne fuqi.

Shoqeria ka te drejten e venies ne ipoteke te elementeve te saj pasuror ne baze te legjislacionit ne fuqi dhe ne perputhje me kushtet dhe frymen e ketij statuti.

Ortaket mbajne pergjegjesi karshi shoqerise deri ne nivelin e kontributit te tyre me kapitalin baze.

Personeli i huaj i shoqerise ka te drejten e pagimit te tij ne valute te huaj dhe te eksportimit te saj jashte.

Ortaku i huaj ka te drejte te eksportoje fitimin e tij jashte ne valute te huaj.

Ortaku i huaj gjithashtu ka te drejte te eksportoje lirisht lende te para produkte dhe sherbime qe jane paguar me valute vendase nga fitimet e tij qe rezultojne nga pjesemarrja e tij ne shoqeri konform legjislacionit shqiptar

Ortaket mund te riinvestojne fitimet e tyre ne teritorin e Republikes se Shqiperise.

Shoqeria ka te drejte te siguroje personelin e saj e te pasurise se saj pa asnje kufizim e dallim

Shoqeria gezon te drejtat dhe perjashtimet nga tatimet sipas legjislacionit ne fuqi.

N e n i 5.: Detyrimet e perbashketa ortakeve

Ortaket detyrohen te depozitojne kontributet e tyre ne kapitalin baze sikurse percaktohet ne kontrate.

Cdo ortak nepermjet perfaqesuesve te vet ne Asamblene e Ortakeve detyrohen te sigurojne plotesimin e drejte, te plote dhe ne kohe te detyrimeve te veta ndaj shoqerise dhe ortakut tjeter ne baze te kontrates themeluese dhe te ketij statuti.

N e n i 6: Plotesimi i detyrimeve

Kur një ortak nuk i pergjigjet drejte dhe ne menyre te plote detyrimeve atehere ortakut tjetër e fton me shkrim qe t'i plotesoje keto detyrime brenda 10 diteve pune.
Ne qofte se nuk disiplinohet atehere ortakut i prekur ka te drejte te kerkoje demshperblim. Niveli i demshperblimit do te jete perkatesisht me demin qe ka shkaktuar. Ekspertet kontabel mund te caktojne egzaktesisht nivelin e demshperblimit.

K R E U III

ADMINISTRIMI I SHOQERISE

Neni 7: Asambleja e ortakëve

Asambleja e ortakëve është organi më i lartë i shoqërisë. Përbëhet nga (3) tre anëtarë.

Neni 8: Kompetencat e Asamblese së ortakëve janë :

Ndryshimi i kontratës së krijimit dhe të statutit të shoqërisë si dhe të përqindjes së pjesëmarrjes së ortakëve.
Percaktimin e synimeve që do të ketë shoqëria.
Miratimi i rezultateve vjetore të Shoqërisë dhe emerimi i eksperteve kontabel.
Riorganizimi dhe shkrija ose mbyllja shoqërisë. Organizimi dhe materializimi i projekteve të tjera të veprimtarisë së saj.
Zgjedhja e administratorëve të shoqërisë.
Mundësia e riinvestimit të fitimeve të saj në territorin e Shqipërisë pasi të jetë parashtruar nga administratorët.
Miratimi i raportit vjetor të punës së kryer nga administratorët e shoqërisë.
Administrimi ekonomik i elementeve pasurore të shoqërisë.
Miratimi i çdo lloji garancie (ipoteke, pengu) të ofruar nga shoqëria në formën e së drejtës së posedimit të pasurisë së shoqërisë si dhe të garancive të tjera që kanë të bëjnë me borxhet e shoqërisë në bazë të legjislativës së fuqi.
Percaktimi i nivelit të pagesës së administratorit dhe të eksperteve kontabel.
Për marrjen e vendimeve që kanë të bëjnë me nenin 8, paragrafi i 1,2,3, kërkohet unanimiteti. Për rastet e tjera Asambleja e Ortakëve vendos me shumicë.
Asambleja e ortakëve cakton shpenzimet e anëtarëve të saj në përputhje me aktivitetet e shoqërisë.
Miratimin e buxhetit të shpenzimeve rrjedhese, miratimin e raportit vjetor të administratorit si dhe të raporteve të tjera ekonomike që parashikon ligji, ndarjen e pjesëve të fitimit, ose llogaritjen e saktë të humbjeve brenda afatit 6 muajor që nga mbarimi i vitit ekonomik.
Miratoni rrogat e personelit si dhe numrin e personelit.
Miratoni vlerën e shoqërisë.
Mundësinë e riinvestimit të fitimeve të shoqërisë në Shqipëri dhe jashtë saj.
Emerimin dhe shkarkimin nga detyra, caktimin e shpërblimit dhe vlerësimit të aktivitetit vjetor të administratorit.



Emerimin e eksperteve kontabel dhe miratimin e raportit te tyre.
Zgjerimin e synimeve dhe te fushave te veprimtarise se shoqerise.

N e n i 9: Mbledhjet vjetore

Shoqeria organizon nje here ne vit mbledhjen e Asamblese se Ortakeve te Shoqerise.
Mbledhja e Jashtezakonshme te ortakeve provokohet nga administratoret apo nga ekspertet kontabel ose nga ortaket te cilet disponojne se paku 15% pjesemarrje ne shoqeri.
Ne mbledhjen e pergjithshme vjetore te ortakeve kryeson kryetari i asamblese se ortakeve ose zevendesi i tij. Ne rast te kundert (kur ai mungon) atehere kryeson nje anetare i mbledhjes qe do te grumbulloje shumicen. E njejta vlen edhe per mbledhjen e jashtezakonshme te ortakeve.

N e n i 10: Administratoret

Te gjitha ortaket jane administratore.
Ortaket vendosin unanimesht nje administrator i cili nuk eshte ortak.
Administratori mun te kryeje te gjitha veprimtarite e administratorit ne interes te shoqerise.
Ne marredhenie me te tretet administratori angazhon shoqerine nepermjet akteve qe jane ne perputhje me aktin e saj.

K R E U I V

UDHEZIME EKONOMIKE

N e n i 11: Kapitali baze (themeltar)

Per te siguruar funksionimin fillestar te shoqerise ortaket formojne kapitalin baze prej njeqindmije leke te ndare si vijon:

Dhimitrios Dollkas	40%	leke 40000
Julia Dollka	40%	" 40000
Gani Cela	20%	" 20000

Nga momenti i vendosjes se kontributit ne kapitalin baze shoqeria fiton te drejten e pasjes, perdorimit dhe disponimit te ketij elementi pasuror ne perputhje me udhezimet e ketij statuti.

N e n i 12 : Llogarite e shoqerise

Shoqeria mban llogarite ne leke.

Te gjitha shpenzimet e shoqerise ne valute duke perfshire edhe fitimet qe u jepen pjesemarrjesve sigurohen:ose nga arketimet ne valute nga veprimtaria e saj ose nga blerja e valutes se huaj ose nga menyra te tjera qe lejon legjislacioni ne fuqi.



pjesëmarrësve sigurohen : ose nga arketimet ne valute nga vaprintaria e saj ose nga blerja e valutes se huaj ose nga menyra te tjera qe lejon legjislacioni ne fuqi.

N e n i 13: Viti ekonomik

Viti ekonomik fillon me 1 janar dhe mbaron me 31 dhjetor te vitit kalendarik.

N e n i 14 Buxhetet- dhenia e llogarise ekonomike

Shoqeria funksionon mbi bazen e udhezimeve te vecanta dhe te planeve qe jane miratuar nga asambleja e ortakeve.

Shoqeria mban ne menyre te pavarur librat e saj kontabile dhe situacionet.

Kontrolli i pergjithshem kontabel dhe statistikor behet mbi bazen e dispozitave qe veprojne ne Shqiperi.

Librat kontabile mbahen ne gjuhen shqipe.

Shumat ne leke konvertohen perkatesisht me kursin zyrtar te asaj dite qe behet kembimi.

Brenda tre muajve nga mbarimi i vitit ekonomik behet bilanci dhe nxirren perfundimet e veprimtarise (fitimet- humbjet) te vitit te kaluar.

Me qellim qe te ushtroje te drejten e kontrollit, cdo ortake ka te drejte te marre informata dhe te kontrolloje cdo ceshtje qe u takon veprimtarive te shoqerise. Cdo ortak gezon te drejten ne cdo kohe te marri njoftime per shkresat e shoqerise dhe per te dhenat pasurore me qellim qe te ushtroje cdo kontroll mbi to.

N e n i 15: Kontrolli kontabel

Shoqeria mban librat kontabile per te regjistruar te gjitha veprimet e saj ne baze te udhezimeve te pergjitheshme kontabile qe veprojne ne Shqiperi.

Librat kontabile kontrollohen cdo vit nga ekspertet kontabel.

N e n i 16: Kredite (huate)

Shoqeria ka te drejte te marri kredi ne leke dhe ne valute nga bankat shqiptare dhe te huaja ne baze te ligjeve shqiptare ne fuqi dhe te procedurave te ketij statuti.

N e n i 17: Ndarja e fitimeve

Fitimet e shoqerise do te ndahen ortakeve sipas kriterëve te nenit 11 te cilat mund te eksportohen jashte nga ortaku i huaj ne baze te ligjeve ne fuqi.

Ortakët mund te riinvestojne fitimet e tyre ne territorin e Republikës se Shqiperise ne baze te ligjeve ne fuqi.

Asambleja e ortakeve mund te zgjeroje veprimtarite e shoqerise ne veprimtari te tjera ne territorin e Shqiperise.



K R E U V

RASTET E NDERPRERJES (MBYLLJES) SE VEPRIMTARISE SE SHOQERISE

N e n i 18: Rastet e nderprerjes se veprimtarise se shoqerise

Ortaket kane te drejte qe ti nderpresin marredheniet qe rrjedhin nga kontratat e krijimit dhe statuti kur vertetohen aresyet serioze qe vijojne :

Ne qoftese me gjithë paralajmerimin e shkruar shkelen nga nje ortake kushtet e kontrates se krijimit dhe statudit me rrjedhoje shkeljen e veprimtarise ekonomike te shoqerise dhe ne qoftese kjo shkelje nuk rikuperohet nga ortaku tjetër me gjithë paralajmerimin e bere me shkrim atehere ceshtja teresisht do te diskutohet ne mbledhjen e asamblese se ortakeve. Ne qoftese ndonje veprim i organeve shteterore drejtpersedrejti ose terthorazi ndalon ushtrimin e te drejtave te njerit, ortaku (te drejten e transferimit te fitimeve dhe ndarjes se pasurise, ndalime lidhur me personelin) dhe si rrjedhoje bejne te pamundur plotesimin e kushteve qe pershkruhen ne kontraten e krijimit dhe te ketij statuti.

Kur vertetohen kushtet e forces madhore qe parashikon ligji.

Shkrirja e shoqerise behet ne rastet qe permenden ne kete nen si dhe ne rastet qe vijojne

:

Varferimi i shoqerise

Dalja e nje vendimi nga organet kompetente qe ndalon veprimtarine e shoqerise ne qoftese nje funksionim i tille vjen ndesh me ligjin dhe gjate kohes qe vepron vendimi.

Marrja e vendimit unanim nga ortakët.

K R E U VI

DISPOZITA TE PERGJITHESHME

N e n i 19: Ndryshime te favorshme ne legjislacionin shqiptar

Ne qoftese ne Republiken e Shqiperise shpallen ligje, dekrete ose vendoset nje politike me e favorshme nga legjislacioni ekzistues gjate kohes se vendosjes se shoqerise atehere ortakët kane te drejte (n.q.se eshte e domosdoshme) t'ju drejtohen organeve perkatese shteterore qe te zbatojne legjislacionin me te favorshem.

Ne rast te kundert dmth. kur shpallen ligje e rregulla me negative ortakët e huaj mbrohen nga garanci qe permenden ne kete statut. Nderkaq ruajne te drejten e nderprerjes se funksionimit te shoqerise pas kerkeses se tyre.



N e n i 20: Personeli i Shoqerise

Me perjashtim te personelit drejtues shoqeria kryesisht perbehet nga shtetas shqipttare. Asambleja miraton perberjen e personelit te shoqerise pas raportimit perkates nga Kryetari i Mbledhjes se Ortakeve. Shoqeria persa i takon personelit zbaton legjislacionin shqiptar.

N e n i 21: Adresat ligjore te ortakeve :

Dhimitrios Dollkas
Greqi, Athine
Rruga Agjiu Joanu 17
Tel. 00301- 9922768

Julia Dollka
Greqi, Athine
Rruga Agjiu Joanu, 17
Tel. 00301-9922768

Gani Cela
Shqiperi, Berat
Lagja 28 Nentori
Rruga Petrit Lerbo,17

N e n i 22: Hyn ne fuqi

Ky statut i pranuar nga ortaket hyn ne fuqi nga momenti qe e kane nenshkruar palet. Palet e lartepermendur nenshkruajne sipas rregullave ne vendin dhe daten e permendur. U nenshkrua ne Tirane me 10.01.1995 ne kater kopje. Te gjitha kopjet jane te vlefshme.

O R T A K E T

GANI CELA


JULIA DOLLKA

DHIMITRIOS DOLLKAS

8132/11

Z B Dajlan
19 PRIL 2005

PULLE TAKSE



KERKUESI: Gani CELA, i biri Dajlanit , i datelindjes 02.01.1957, lindur dhe banues ne Berat

OBJEKTI: Depozitimi i vendimit te dates 28.03.2005 Asamblese se Ortakeve te Shoqerise tregtare "DOAR"sh.p.k

**PERPARA GJYKATES SE SHKALLES SE PARE
TIRANE**

Shoqeria tregtare "DOAR" shpk eshte krijuar si person juridik me vendimin e Gjykates Tirane Nr.8132 date 17.01.1995. Me vendim te Asamblese se ortakeve te saj te dates 28.03.2005 eshte vendosur per ndryshime ne zoterimin e pjeseve te kapitalit themeltar, te kohezgjatjes se veprimtarise se shoqerise dhe ne emerimin e administratorit te saj.

Ne zbatim te ligjit nr. 7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" dhe te ligjit nr.7667 date 28.01.1993 "Per rregjistrin tregtar", kerkohet depozitimi i vendimit te dates 28.03.2005 te Asamblese se Ortakeve te shoqerise tregtare "DOAR" sh.p.k.

Bashkangjitur kesaj kerkese ju paraqitim:

1. Vendimin e Asamblese se ortakeve te dates 28.03.2005.
2. Kontraten e shitjes se pjeseve te kapitalit themeltar.

KERKUESI

ADMINISTRATORI I SHOQERISE "DOAR"Sh.p.k

Gani CELA

*Co depozitimet
te ortakeve dt
28.03.05
Vendimi: Ar Jan
dt 28.3.05
prez. sut sh.p.k.
kontrate shitje
dt 28.3.05
(ne Atene)
prez. sut sh.p.k.*

REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTERE ARBEN NDINO, BERAT
Nr 469

VERTETIM

Sot, me 02.04.2005 para meje Noterit Arben Ndino ne Berat, u paraqit personalisht Z.Gani Dajlan Cela lindur dhe banues ne Berat me numer pasaporte Z 0915652 ne cilesine e Administratorit te Shoqerise "DOAR" Sh.p.k, madhore, me zotesi te plote juridike per te vepruar, per identitetin e te cileve u sigurova pasi verifikova dokumenin e tij identifikuese. Ai pasi lexoi kerkesen e mesiperme, e nenshkroi lirisht para meje Noterit me vullnetin e tij te lire, dhe une Noteri e vertetoj ate sipas ligjit.

**NOTERI
Arben NDINO**

ΣΥΜΒΟΛΑΙΟ ΠΡΟΤΗΣΗΣ

Σήμερα στις 28/3/05 οι δύο γαμπροί, είναι συμφωνοί για να κάνουν το συμβολαίο της γέννησης που γραφτεί παρακάτω:

Οι γωάντες:

- 1. Δημήτριος Ντούγκας, γεννημένος στην Αθήνα, κάτοικος στην Αθήνα
- 2. Ιουλιја Ντολκα, γεννημένη στην Αθήνα, κάτοικος στην Αθήνα.

Ο Αγοραστής:

Γκωνη Τσέτα, γεννημένος και κάτοικος στο Μηράτη της Αλβανίας.

Οι δύο γαμπροί είναι τη εφαιρούμενη από το νότο, και με την θέληση τους κάνουν το συμβολαίο της γέννησης που γραφτεί παρακάτω:

Οι γωάντες ο κύριος Δημήτριος Ντούγκας και η κυρία Ιουλιја Ντολκα είναι συνεταιροί της εταιρείας "DOAR" και ο καθένας έχει από 40% του θεμελίου κεφαλαίου ενώ ο αγοραστής έχει 20% του θεμελίου κεφαλαίου της εταιρείας συνεταιροί της εταιρείας "DOAR".

Οι γωάντες, ο κύριος Δημήτριος Ντολκας και κυρία Ιουλιја Ντολκα από 40% του θεμελίου κεφαλαίου της εταιρείας ο καθένας

τα γωάει στον κύριο Γκωνη Τσέτα με την τιμή 15000 Ευρώ

Ο γωάντης Δημήτριος Ντούγκας τα 40% της εταιρείας "DOAR"

τα γωάει με την τιμή 15000 ευρώ, στον κύριο Γκωνη Τσέτα

Ο γωάντης Ιουλιја Ντολκα τα 40% της εταιρείας "DOAR" τα

γωάει με την τιμή 15.000 ευρώ, στον κύριο Γκωνη Τσέτα

Οι γωάντες δηλώνουν που έχουν ήδη όλο το ποσό από τη γέννηση, ο κύριος Γκωνη Τσέτα, γίνεται ο τόνος συνεταιρος, έχοντας 100% του θεμελίου κεφαλαίου της εταιρείας "DOAR" κοινή εταιρεία.

Βεβαιώνεται το γνήσιο της υπογραφής της

ΝΤΟΛΚΑ ΙΟΥΛΙΑΣ

Οι γωάντες ΝΤΟΛΚΑΣ ΔΗΜΗΤΡΙΟΣ

Ο αγοραστής Γκωνη Τσέτα





KONTRATE-SHITJE

Sot me date 28.03.2005, ne Athine, ortaket e shoqerise "DOAR" SHPK rane dakort te hartojne kontraten e shitjes e cila redaktohet si me poshte:

SHITESIT: 1. DHIMITRIOS DOLLKAS lindur ne Athine dhe banues ne Athine.
2. JULIA DOLLKA lindur ne Athine dhe banues ne Athine.

BLERESI: GANI CELA lindur dhe banues ne Berat Shqiperi.

Te dy palet te afte per te kryer veprime ligjore dhe me vulnetin e tyre te lire hartuan kontraten e shitjes si me poshte vijon:

Z. Dhimitrios DOLLKAS dhe Julia DOLLKA si shites jane ortake te shoqerise "DOAR" shpk dhe sejcili zoteron 40% te kapitalit themeltar te shoqerise, kurse bleresi zoteron 20% te kapitalit themeltar te shoqerise.
Shitesit, Z.Dhimitrios DOLLKAS dhe zj,Julia DOLLKA shesin perkatesisht nga 40% te kapitalit themeltar te shoqerise tek z.Gani CELA me çmimin 15.000 euro sejcili dhe konkretisht:

Z.Dhimitrios DOLLKAS ja shet 40% te kutave te kapitalit themeltar te shoqerise Z.Gani CELA me cmimin 15.000 euro.
Z.Julia DOLLKA ja shet 40% te kutave te kapitalit themeltar te shoqerise Z.Gani CELA me cmimin 15.000 euro.

Shitesit deklarojne se e kane mare te gjithë vleren e shitjes nga Z.Gani CELA i cili behet ortak i vetem duke zoteruar 100% te kapitalit themeltar te shoqerise "DOAR" shpk.

SHITESIT
Dhimitrios DOLLKAS
Julia DOLLKA
Firma dhe Vula

BLERESI
Gani CELA
Firma

Firma dhe vula e qendres se shitjes ne Bashkine Iliopolis
LENI BOKA

PERKTHEU
Angjello MICI

ATTENZIONE! MHTENZ!
NOTA: VERBA ET SCRIPTA MANENT!

Έγκριση Συνέλευση της Εταιρείας Doan "κοιμή Ελευρεία"
Απόφαση

Σήμερα στις 28/03/05, η Έγκριση συνέλευση της εταιρείας
Doan εγγεγραμμένη σαν νομιμο πρόσωπο, με απόφαση του Δικαστη-
ριου Περιφέρειας Επώνων με αριθμό 8132 η/ν/α 13/01/1995,
βασύ του καταστατικού της Εταιρείας:

ΑΠΟΦΑΣΗ

1. Εγκρίνει την πώληση των 40% του μετρίου κεφαλαίου που
ανήκουν στην Ελευρεία, του συνεταιρισμού Δημητρίου Ντόλκα και
Ιουλιανή Ντόλκα, στον κύριο Γκάνη Τσέτσα σύμφωνα με το
Σύμβαση γραφικό Σχέδιο της πώλησης αριθ. η/ν/α
28103/05.

2. Ψεφεία από την πώληση του μετρίου κεφαλαίου από τον
κύριο Δημήτρη Ντόλκα και κυρία Ιουλιανή Ντόλκα, το μετριο
της εταιρείας κεφάλαιο ανήκει 100% από τον κύριο Γκάνη
Τσέτσα ο οποίος γίνεται ο μόνος συνεταιρισμός.

3. Η γαράντιση σαν διαχειριστής του Δημητρίου Ντόλκα και
Ιουλιανή Ντόλκα εγκρίνεται γιατί αυτοί έχουν πωλήσει
πλήρως το μετριο κεφαλαίο που τους ανήκει. Ο κύριος
Γκάνη Τσέτσα θα είναι διαχειριστής της εταιρείας.

4. Εν αλλαγή του άρθρου 8 της εταιρείας το οποίο διατά-
ζει παρακάτω ο χρόνος της δραστηριοποίησης της εται-
ρίας είναι χωρίς προθεσμία

Οι συνεταιριστές της Εταιρείας "Doan"

Γκάνη Τσέτσα

Δημήτριος Ντόλκας

Ιουλιανή Ντόλκα

Οι Δημητρίου Ντόλκα
Ντόλκα

[Handwritten signature]

Βεβαιώνεται το γνήσιο της
επογραφής ΗΣ *[Handwritten signature]*

38664306
3
5

Ντόλκα Ιουλιανή
Κ 319094
28 3

Γκάνη Τσέτσα

[Handwritten signature]



ASAMBLEJA E JASHTEZAKONSHME E SHOQERISE
"DOAR" SHPK

V E N D I M

Sot me date 28.03.2005, ne Athine, Asambeja e jashtezakonshme e shoqerise "DOAR" shpk, shoqeri e rregjistruar si person juridik me vendim te Gjykates se rrethit Tirane Nr. 8132 date 13.01.1995, ne mbeshtetje te statutit te shoqerise,

V E N D O S I


1. Miratimin e shitjes 40% te pjeseve te kapitalit themeltar qe zoteron ne shoqeri z.Dhimitrios DOLLKAS dhe 40% te pjeseve te kapitalit themeltar te ortakut zj.Julia DOLLKA te ortakut z.Gani CELA sipas kontrates se shitjes date 28.03.2005
2. Pas shitjes teresisht te pjeseve te kapitalit themeltar nga z.Dhimitrios DOLLKAS dhe zj.Julia DOLLKA, kapitali themeltar zoterohet 100% nga z. Gani CELA.
3. Miratohet doreheqja si Administrator te z.Dhimitrios DOLLKAS dhe zj.Julia DOLLKA pasi ata kane shitur teresisht pjeset e kapitalit themeltar te z. Gani CELA i cili ngelet Administrator i vetem i shoqerise.
4. Ndryshimin e kohezgjatjes se veprimtarise se shoqerise. Kohezgjatja e veprimtarise se shoqerise eshte pa afat.

ORTAKET
Dhimiter DOLKA
Iulia DOLKAS
Gani CELA
FIRMAT

Firma dhe vula e qendres se shitjes ne Bashkine Iliopolis
LENI BOKA

PERKTHEU
Angjello MICI

ΑΓΕΛΟΣ ΜΗΤΣΗΣ
ΝΟΜΙΜΟΣ ΜΕΤΑΓΡΑΦΤΗΣ





8132

Kerkuesit :

- 1. Dhimitrios Dollkas**, i Gjeorgjiut dhe Julias, lindur ne Athine, shtetas Grek me pashaporte Nr. Z-3892282
- 2. Julia Dollka**, i Spiridhonit dhe Dhimitras, lindur ne Athine me 1951 dhe banues ne Athine, shtetase greke, me pashaporte Nr. K-319094
- 3. Gani Cela**, i Dajlanit dhe Ferasetes, lindur ne Berat me 1957, banues ne Berat, shtetas shqiptar me pashaporte Nr. QH-019342.

Objekt:

*Co regjistruar
dt. 17-1-95
Dollka*

Regjistrimi si person juridik Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar "DOAR-SH.P.K." ne baze te ligjit Nr.7638, Date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare" dhe ligjit Nr.7667 dt. 28.1.1993 "Per regjistrin Tregtar".

GJYKATES SE RRETHIT

TIRANE

Ne kerkuesat e mesiperme si ortakë kerkojme regjistrimin e Shoqerise Tregtare "DOAR-SHPK" me qender ne Berat me kohezgjatje 10 vjet , me kapital baze 100.000 leke me ortakë te tre kerkuesit me administratore Dhimitrios DOLLKAS dhe Gani CELA; me objekt "Import-Eksport" mallrash te ndryshme dhe veprimtari prodhimi druri te te gjitha llojeve, si bufe, dhome gjumi, dyer-dritare, sallone, mobileri, paisje hotelesh, zyresh e dyqanesh, karrike e kolltuqe te llojeve te ndryshme, tapiceri e cdo lloj prodhimesh druri.
Bashkelidhur jane kontrata e firmosur dhe statuti i Shoqerise.

K E R K U E S I T

GANI CELA

JULIA DOLLKA

DHIMITRIOS DOLLKAS

G. Cela

J. Dollka

A. Dollkas